# DËSHMI ARKIVI

**A-455397**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ronaldo grumbullohet sërish pas Botërorit, CR7 do të luajë ndeshjet e radhës me Portugalinë në Ligën e Kombeve |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/ronaldo-grumbullohet-serish-pas-boterorit-cr7-do-te-luaje-ndeshjet-e-radhe-i104858` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 13:49:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 13:34:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ee4b27b7c56fdd1f6f69272ff2a451e0425751c9b2e27dc8da2fadd69f25f8ef` |
| TEKSTI | `e10fe80e173b7e149ee8cb933205f4d780757e99c59421e714a8a59f01bb19a8` |
| PAMJA | `1108c1fec2f56c3266f862c10b7ee9281efc60226160826046c0e2b4baef32f2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1a734793896344306d8fc620bc5c7da5d4485042300f67e8a4263989e0df36b7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1a734793896344306d8fc620bc5c7da5d4485042300f67e8a4263989e0df36b7`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Ronaldo grumbullohet sërish pas Botërorit, CR7 do të luajë ndeshjet e radhës me Portugalinë në Ligën e Kombeve

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 15:34



Jorge Jesus ka publikuar listën e tij të parë si trajner i Portugalisë dhe në të është edhe Cristiano Ronaldo. Trajneri i ri i luzitanëve ka mbajtur pjesën më të madhe të grupit që mori pjesë në Botërorin 2026, duke i dhënë kështu një tjetër mundësi kapitenit 41-vjeçar.

Ronaldo është grumbulluar për ndeshjet e ardhshme të Portugalisë, ndërsa rikthimi i tij vjen në një moment kur e ardhmja e sulmuesit me Kombëtaren mbetet një prej temave më të diskutuara.

Gjatë Botërorit të këtij viti, Ronaldo konfirmoi se turneu në SHBA, Meksikë dhe Kanada do të ishte Kupa e tij e fundit e Botës. Pas eliminimit të Portugalisë nga Spanja në fazën e 1/8-ve, ai deklaroi se nuk dëshironte të merrte vendime të nxituara për të ardhmen e tij me Kombëtaren. FIFA konfirmoi gjithashtu se Ronaldo kishte mbyllur kapitullin e tij në Kupën e Botës, por jo domosdoshmërisht atë me përfaqësuesen portugeze.

Më herët, në nëntor 2025, Ronaldo kishte thënë se synonte të tërhiqej nga futbolli brenda "një ose dy vitesh", ndërsa në gusht të këtij viti deklaroi se sezoni 2026/27 ishte "ndoshta" i fundit i karrierës së tij.

Për momentin, megjithatë, ai vazhdon të jetë pjesë e planeve të Portugalisë.

Jorge Jesus mori drejtimin e Portugalisë pas largimit të Roberto Martinez dhe ka deklaruar më herët se nuk kishte ndërmend të bënte ndryshime drastike në skuadër. Ai e ka lënë të hapur vazhdimin e bashkëpunimit me Ronaldon, duke e konsideruar sulmuesin një figurë qendrore për ekipin për sa kohë që është në gjendje fizike të luajë.

Në listën e re janë përfshirë edhe emra të rëndësishëm si Nuno Mendes, Vitinha dhe João Neves, ndërsa një tjetër emër i rikthyer është ish-mbrojtësi i Marseille, Nuno Tavares.

Portugalia do të ketë një kalendar të ngjeshur në këtë periudhë ndërkombëtare, me sfida ndaj Uellsit, Norvegjisë, Danimarkës dhe sërish Norvegjisë.

Kështu, aventura e parë e Jorge Jesus në krye të Portugalisë nis me një vendim që tërheq vëmendjen: Cristiano Ronaldo vazhdon të jetë pjesë e Kombëtares, pavarësisht se Botërori 2026 ishte konfirmuar prej tij si i fundit në karrierë.


## Artikuj te sugjeruar

SPORT 18 Shtator15:27

Roma-Inter/ Gasperini ul entuziazmin para supersfidës: Ata janë skuadra më e fortë në Serie A, shifrat e tregojnë superioritetin

Roma dhe Interi përballen në një prej sfidave më të rëndësishme të kësaj faze të kampionatit, me të dyj...

SPORT 18 Shtator15:21

Del lista e Kosovës, mes të grumbulluarve edhe talenti i Bayern

Kosova do të përballet në Nations League me Irlandën, Austrinë dhe Izraelin. Pak më parë, tekniku i dardanëve, Franco ...

SPORT 18 Shtator14:46

**“E meritoj Topin e Artë”, Lamine Yamal shpall veten favorit...**

Ndryshe nga Harry Kane, Lamine Yamal është totalisht i bindur kur pyetet në lidhje me favoritin për “Topin e Artë”. N&eu...

SPORT 18 Shtator14:41

**Foda reagon pas çështjes Rrahmani: Ka shumë dramë, po ekzagjerohet …**

Trajneri i Kosovës, Franco Foda, ka konfirmuar se kapiteni Amir Rrahmani e ka njoftuar personalisht për vendimin e tij për t’u tërhe...

SPORT 18 Shtator14:37

**Massara i jep besim Spallettit: “Juventusi, në duar të shkëlqyera pavarësisht pikëve të humbura”**

Shefi i Futbollit i Juventusit, Ricky Massara, ka shprehur besim të plotë te trajneri Luciano Spalletti, duke theksuar se skuadra është n&...

SPORT 18 Shtator14:25

**Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: “Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar”**

Jürgen Klopp, 80 ditë pas eliminimit të Gjermanisë nga Kupa e Botës së fundit në raundin e 1/16-ve kundër Paraguajit, ...

SPORT 18 Shtator13:49

**Dinamo kërkon fitoren e katërt radhazi ndaj Laçit/ Daja paralajmëron: Duhet të kemi kujdes në tranzicion**

Dinamo synon të vijojë serinë e rezultateve pozitive në Abissnet Superiore, teksa këtë javë përballet me Laçin ...

SPORT 18 Shtator13:37

**Pa kontratë, por ende në klub: Paul Pogba nuk është gati t’i varë këpucët në gozhdë**

Duke ndjekur gjithmonë nga afër lajmet e ekipit kombëtar francez, me të cilin mban një lidhje të veçantë, Paul Pogba...

SPORT 18 Shtator13:11

**Spanja, rikthime dhe mungesa, De la Fuente publikon listën**

Në Spanjë, ndryshimet janë me “pikatore”, me trajnerin De la Fuente që i beson të njëjtit grup që në 4 vit...

SPORT 18 Shtator13:07

**Dy filozofi të ndryshme, Roma-Inter, ose mbrojta kundër sulmit më të mirë**

Roma dhe Interi përballen në një duel që premton spektakël, mes dy skuadrave që kanë nisur sezonin me pikë t&eum...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

**"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...**

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

AKTUALITET 17 Shtator

**Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jet...**

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

**Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...**

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

**video**



**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.